

## PROMOVIMI I MENAXHIMIT TË QËNDRUESHËM TË TOKËS (MQT) NË SHQIPËRI PËRMES RESTAURIMIT TË INTEGRUAR TË EKOSISTEMEVE

### Konteksti

Degradimi i tokës është një kërcënim i vazhdueshëm për mirëqënien socio-ekonomike dhe mjedisore të Shqipërisë. Ky program u projektua për të mbështetur adoptimin e gjerë të aktiviteteve të Menaxhimit të Qendrueshëm të Tokës (MQT) në vend, duke mbështetur planifikimin e integruar të menaxhimit të mbetjeve që merr parasysh si nevojat e zhvillimit ashtu dhe shërbimet mjedisore.

Projekti trajtoi elementët kryesorë të degradimit të tokës në Shqipëri, në përputhje me objektivat e Programit Kombëtar të Veprimit (NAP) të UNCCD-së, me fokus në shpyllëzimin, menaxhimin jo të duhur të tokës dhe menaxhimin e papërshtatshëm të ë mbjellave.

### Objektivat e Projektit

Objektivat specifikë të këtij projekti ishin:

- Rishikimi i kuadrit ekzistues ligjor dhe institucional të menaxhimit të tokës dhe ngritjes së kapaciteteve;
- Rritja e ndërgjegjësimit për çështjen e menaxhimit të tokës;
- Zhvillimi i kapaciteteve institucionale në nivel kombëtar dhe vendor.

### Produktet

- Vlerësimi i legjislacionit për menaxhimin e tokës, duke përfshirë një analizë të mangësive me legjislacionin e BE-së dhe miratimi i rekomandimeve në një ligj të ri për menaxhimin e tokës;
- Organizimi i tre seminareve me palët kryesore të interesit, 4 takimeve tremujore ndërministrare dhe 10 takimeve me komunitetet për të lehtësuar ndërveprimin mes komuniteteve vendore dhe anëtarëve të Komisionit;
- Zhvillimi i disa mekanizmave për mbledhjen dhe ndarjen e informacionit ndërmjet anëtarëve të Komisionit dhe institucioneve të tjera relevante në nivel kombëtar dhe vendor;
- Zhvillimi i Raportit të Vlerësimit të Nevojave për Trajnim;
- Përpilimi i Raportit me gjetje nga Strategjia e Decentralizimit për Reformën Territoriale dhe Administrative, duke detajuar zhvendosjen e përgjegjësive për menaxhimin e tokës;
- Përpilimi i Raportit mbi Instrumentet Ekonomike për stimulimin e investimeve për prodhimet e tokës;
- Përgatitja e Strategjisë së Komunikimit;
- Përgatitja e materialeve të trajnimit të MQT dhe ofrimi i trajnimit;
- Përgatitja dhe transmetimi i spotit televiziv në televizion kombëtar në Ditën Botërore të Dheut dhe Ditën Ndërkombëtare të Pujëve;
- Krijimi i platformave vendore të komunikimit.

#### INFORMACION I PËRGJITHSHËM

##### DONATORI:

Global Environment Facility  
(GEF)

##### PARTNERËT:

- Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (UNEP)
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Bashkia Kolonjë
- Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU)

##### KOHËZGJATJA:

01/10/2018 - 30/04/2019

##### KONTAKT:

Zana Vokopola  
Drejtor Ekzekutiv  
Instituti i Kërkimeve Urbane  
Rr. Asim Vokshi, Nd. 14 Hyrja 11,  
Ap. 56 Tiranë, Shqipëri  
M: +355694333808  
E : zvokopola@uri.org.al

### Breth IKU

Që nga viti 1999, Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë fokusohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojmë në qeveri, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim qasjen e publikut në informacion dhe lidhim partnerët e zhvillimit. URI ka punuar me donatorë si USAID, Swiss Cooperation, Ambasada Hollandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Fondacioni Shoqëria e Hapur, etj.

